



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-p.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/254  
Datë: 17 / 7 / 2024

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 12.07.2024, bazuar në nenet 20.1 paragrafi 2.1 dhe 147, paragrafi 3.9 të Statutit të UP-së, miraton:

**RREGULLOREN E PROCEDURAVE VLERËSUESE PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për mbajtjen e ligjëratave, përkatësisht ushtrimeve, si dhe provimeve, kollokviumeve, konsultimeve, mentorimeve sipas nevojës dhe ndërlidhjen e programeve të Universitetit të Prishtinës, me aktorët e tregut të punës, përmes procesit mësimor dhe praktik, bazuar edhe në standardet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA).

**Neni 2**  
**Baza ligjore**

Kjo rregullore ka për bazë Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit të Prishtinës, Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim si dhe standardet e miratuara nga AKA-ja.

**Neni 3**  
**Angazhimi bashkëpunëtorëve të jashtëm**

1. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm bazohen në nevojën e sigurimit të veprimtarisë së qëndrueshme të Universitetit të Prishtinës në përputhje me obligimet e tij, me theks të veçantë në aktivitetet si në vijim:
  - 1.1. Aktivitetin mësimor (ligjërata, ushtrime);
  - 1.2. Aktivitetin konsultativ;
  - 1.3. Mbajtjen e provimeve në lëndët në të cilat angazhohen;
  - 1.4. Mentorimin e temave në nivelin bachelor;
  - 1.5. Ndërlidhjen e procesit mësimor me tregun e punës përmes praktikës;
  - 1.6. Procesin e sigurimit të cilësisë;
  - 1.7. Përshtatjen me standardet e akreditimit.

9.9.

2. Planifikimi i angazhimeve bazohet në nevojat reale për të siguruar veprimtarinë e qëndrueshme të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht njërive akademike.

#### **Neni 4** **Periudha e angazhimit**

1. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet për një semestër, përkatësisht për dy semestra, të të njëjtit vit akademik, ndërsa kontrata lidhet për vitin akademik përkatës.
2. Pas vlerësimit pozitiv për bashkëpunëtorin/en, me propozim të dekanit, angazhimi mund të vazhdohet edhe për 1 vit akademik, e jo më shumë se 2 vite të tjera (4 semestra), pa shpallur thirrje publike. Propozimi i arsyetuar i dekanit duhet të miratohet në senat. I angazhuari ka për obligim që, në kuadër të kontratës, të mbajë provimet për të gjitha afatet brenda vitit përkatës akademik.
3. I angazhuari mund të jetë anëtar i komisionit për mbrojtjen e temave në nivelin bachelor dhe në master.
4. I angazhuari, nëse e ka titullin dr. sc. ose ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve, ka të drejtë të mentorojë kandidatët në nivelin bachelor.

#### **Neni 5** **Thirrja publike për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm**

1. Procedura e angazhimit bëhet nëpërmjet shpalljes së thirrjes publike për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
2. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet për kategoritë si në vijim:
  - 2.1. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune, i cili në bazë të normave ligjore në fuqi ka pezulluar marrëdhënien e rregullt të punës, nëse normat ligjore brenda dhe jashtë UP-së lejojnë mundësinë e angazhimit të tyre në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
  - 2.2. Personeli i cili në momentin e plotësimit të moshës mandatore të pensionit ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Prishtinës dhe nëse fakulteti ka nevojë për angazhimin e tyre. Angazhimi i kësaj kategorie të bashkëpunëtorëve mund të bëhet deri në moshën e lejuar me akte të veçanta.
  - 2.3. Lektorët të cilët angazhohen si rezultat i bashkëpunimit me ambasada dhe me agjenci shtetërore të vendeve përkatëse apo marrëveshjeve me universitete të huaja.
  - 2.4. Profesorët vizitorë të punësuar në universitetet dhe institucionet e akredituara të arsimit të lartë jashtë vendit (për një numër të caktuar të ligjëratave deri në një semestër, ose 1 vit akademik për lëndet 2 semestrare), angazhohen me vendim të senatit. Kërkesa për angazhimin e profesorëve vizitorë duhet të bëhet nga dekani i njësisë akademike, bazuar në një raport të arsyetuar, duke u bazuar në nevojat e fakultetit/programave, marrëveshjeve të bashkëpunimit me fakultete/universitete dhe institucione jashtë vendit. Kërkesa mund të bëhet edhe nga këshilli i fakultetit, përmes dekanit, bazuar në nevojën e departamentit/degës përkatëse. Kërkesa, së bashku me arsyetimin për pamundësinë e mbulimit dhe zhvillimit cilësor të orëve përkatëse nga ana e personelit në marrëdhënie të rregullt pune nga fusha e afërt dhe CV-në e profesorit vizitor potencial dorëzohen në rektorat. Në rast të miratimit të

- kërkesës në senat, profesorit vizitor i lejohet realizimi i orëve sipas sistemit bllok, për jo më shumë se gjashtë (6) orë brenda ditës së punës dhe jo më shumë se njëzet e katër (24) orë brenda muajit.
- 2.5. Profesorët vizitorë, në asnjë rrethanë, nuk mund të angazhohen për bashkëligjërime për më shumë se 4 orë ligjërata në lëndët të cilat janë në kuadër të normës së personelit në marrëdhënie të rregullt pune.
  - 2.6. Angazhimi i ekspertëve që mbajnë orë praktike (lëndët klinike apo programet e certifikimit), të cilët janë të punësuar në institucione publike ose ofrojnë shërbime publike sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës, me të cilat Universiteti i Prishtinës ose njësi akademike ka marrëveshje bashkëpunimi, si dhe anagzhimi i tyre është i paraparë me programet e akredituara nga AKA-ja, si pjesë e ndërlidhjes së programit mësimor me tregun e punës. Kjo kategori e ekspertëve kompensohen në pajtim me rregullativën që përcaktohet nga Këshilli Drejtues i UP-së. Për angazhimin e ekspertëve për mbajtjen e orëve praktike (lëndëve klinike apo programeve të certifikimit), njësi akademike duhet të dërgojë një raport të arsyetuar, duke u referuar në programet e akredituara nga AKA-ja, si ndërlidhje e procesit mësimor me tregun e punës, së bashku me listën e ekspertëve që angazhohen për 1 semestër apo vit akademik.
  - 2.7. Angazhimi, me vendim të këshillit të njësisë akademike, i ekspertëve nga sektori privat që janë të punësuar në institucione, me të cilat universiteti ose njësi akademike ka marrëveshje, dhe orët e ushtrimeve, praktike ose aktivitetet e tjera janë pjesë e programit të akredituar nga AKA-ja, si ndërlidhje e procesit mësimor me tregun e punës. Për angazhimin e ekspertëve nga kjo kategori, njësi akademike duhet të dërgojë një raport të arsyetuar, duke u referuar në programet e akredituara nga AKA-ja, si ndërlidhje e procesit mësimor me tregun e punës, së bashku me listën e ekspertëve që angazhohen për 1 semestër apo vit akademik.
  - 2.8. Angazhimi i personaliteteve që kanë arritje të jashtëzakonshme ndërkombëtare në fushën e tyre. Për angazhimin e kësaj kategorie, dekani i njësisë akademike duhet të dërgojë një propozim të arsyetuar që dëshmon arritjet e veçanta e të konfirmuara në nivel ndërkombëtar dhe CV-në e kandidatit/es, për angazhim deri në një semestër ose vit akademik.
3. Thirrja publike për angazhim shpallet nga senati me propozim të fakultetit, bazuar në nevojat e tyre për ligjërata, përkatësisht ushtrime. Fakulteti mund të emërojë një komision për vlerësimin e nevojave ose menaxhmenti bën një analizë të detajuar për këtë qëllim.
  4. Një pozitë mund të shpallet edhe për orët e ligjëratave ose ushtrimeve që janë në kuadër të programeve të dy apo më shumë njësive akademike. Në këto raste, propozimi bëhet nga dekanët e njësive akademike përkatëse.
  5. Rektori, me një arsyetim të bazuar, mund t'i propozojë senatit shpalljen e thirrjes publike për angazhim të personelit në fakultetin e caktuar.
  6. Thirrja publike shpallet në ueb faqen e Universitetit të Prishtinës dhe njësive akademike me kohëzgjatje prej tetë (8) ditëve kalendarike nga dita e shpalljes.
  7. Kandidatët të cilët aplikojnë duhet t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet brenda afatit të thirrjes publike në modulën përkatës të sistemit elektronik të Universitetit të Prishtinës SEMS.

## **Neni 6**

### **Komisioni vlerësues**

1. Komisioni vlerësues propozohet nga dekanit dhe miratohet në këshillin e njësisë akademike.
2. Propozimi i dekanit bazohet në listat e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune që përfaqësojnë katedrat/departamentet përkatëse (rektori, prorektorët, dekanit dhe prodekanët nuk mund të emërohen anëtarë të komisioneve vlerësuese). Në raste të veçanta, anëtarë të komisionit vlerësues mund të propozohen edhe nga njësitë e tjera të UP-së nëse përshtaten me fushën përkatëse.
3. Një komision prej 5 anëtarëve mund të vlerësojë të gjitha pozitave të shpallura për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm brenda njësisë akademike. Në varësi të nevojave dhe specifikave të fakulteteve, mund të propozohen edhe disa komisione të veçanta për pozitave të shpallura, të përbërë nga 3 anëtarë.
4. Komisionet vlerësuese për zbatimin e thirrjes publike duhet të miratohen jo më larg se 8 ditë nga mbyllja e thirrjes.
5. Komisioni vlerësues është organ me kredibilitet të lartë profesional, akademik, etik dhe mban përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për të dhënat e shënuara në raport.

## **Neni 7**

### **Kushtet e angazhimit**

1. Personat e angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm nuk marrin thirrje akademike në UP. Angazhimi i tyre bëhet bazuar në procedurat specifike të përcaktuara me këtë rregullore.
2. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjërata kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:
  - 2.1. Të ketë të paktën gradën shkencore master i shkencave/arteve<sup>1</sup>, ndërsa kandidatët me gradën doktor i shkencave, nga lëmia përkatëse (në Fakultetin e Arteve ekuivalente me të) kanë përparësi.
  - 2.2. Të ketë së paku 1 publikim në revistat shkencore ndërkombëtare (në Fakultetin e Arteve së paku 1 vepër artistike të rangut ndërkombëtar në fushën përkatëse). Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjërata në mjekësi, në lëndët klinike, kandidati duhet të jetë specialist i fushës përkatëse.
3. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:
  - 3.1. Të kenë të përfunduar studimet master ose ekuivalent me të në fushën përkatëse.
  - 3.2. Të ketë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit.
  - 3.3. Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinës (në lëndët klinike të veterinarisë) dhe në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (në lëndët laboratorike<sup>2</sup>)

<sup>1</sup> Kandidati me gradën shkencore master duhet të ketë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit.

<sup>2</sup> Lista e lëndëve klinike të Fakultetit të Mjekësisë, lëndëve klinike të fushës së veterinarisë, lëndëve laboratorike të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe lëndët e kontabilitetit dhe auditimit në Fakultetin Ekonomik është e publikuar në ueb faqen e Universitetit të Prishtinës dhe të fakulteteve përkatëse.

9.91.

kandidati duhet të dëshmojë që ka së paku 3 vjet përvojë pune profesionale në fushën përkatëse.

- 3.4. Në Fakultetin e Mjekësisë (në lëndët klinike), të ketë të përfunduar specializimin ose të jetë së paku në vitin e tretë të specializimit në fushën përkatëse. Angazhimi bëhet duke marrë parasysh edhe Ligjin e Shëndetësisë.
  - 3.5. Në Fakultetin Ekonomik, për ushtrimet në lëndet e kontabilitetit dhe auditimit, kandidati duhet të jetë kontabilist, përkatësisht auditor i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi dhe të ketë së paku 3 vjet përvojë pune profesionale në fushën përkatëse.
4. Në rastin kur më shumë se një kandidat për pozitën përkatëse i plotëson kriteret e paragrafit 2, përkatësisht 3, të këtij neni, mbetet në diskrecionin e komisionit vlerësues dhënia e përparësisë kandidatit të caktuar.
  5. Nëse asnjëri nga kandidatët e paraqitur nuk i plotëson të gjitha kriteret e paragrafit 2, përkatësisht 3, është në diskrecion të komisionit vlerësues që të propozojë një kandidat, duke bërë arsyetim të veçantë për kandidatin që plotëson numrin më të madh të kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore.
  6. Me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit dhe nepotizmit, në Universitetin e Prishtinës nuk mund të angazhohen kandidatët që kanë të punësuar apo të angazhuar në njësinë akademike përkatëse, persona në marrëdhënie familjare (në relacionin prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).
  7. Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit duhet të sjellin vendimin për nostrifikim (barasvlerë) të diplomës përkatëse (baçelor, master, magjistraturë, doktoratë).

## Neni 8

### Afatet e vlerësimit, e drejta në ankesë dhe marrja e vendimit për angazhim

1. Komisioni vlerësues, në afat prej 5 ditëve<sup>3</sup> nga pranimi i vendimit, e përgadit raportin vlerësues. Raporti i komisionit vlerësues publikohet menjëherë në ueb faqe të fakultetit, në kohëzgjatje prej 5 ditëve.
2. Brenda afatit prej 5 ditëve sa raporti është i publikuar në ueb faqe të fakultetit, kandidatët e pakënaqur kanë të drejtën e ankesës në raportin e komisionit vlerësues, pranë komisionit për ankesa të fakultetit.
3. Komisioni i ankesave emërohet nga dekani i njësisë akademike dhe përbëhet nga 3 anëtarë, nga radha e profesorëve në marrëdhënie të rregullt të punës.
4. Komisioni i ankesave, në afatin prej 5 ditëve, i shqyrton ankesat dhe paraqet raport me shkrim për këshillin e fakultetit.
5. Në afatin prej 7 ditëve, këshilli i fakultetit shqyrton raportin e komisionit vlerësues dhe komisionit për ankesa dhe merr vendim përfundimtar për kandidatët që pranohen si bashkëpunëtorë të jashtëm.
6. Vendimi i këshillit të fakultetit, me listën e kandidatëve të pranuar si bashkëpunëtorë të jashtëm, dergohet në senat për informim.

<sup>3</sup> Të gjitha afatet në këtë rregullore nënkuptojnë ditët kalendarike.

**Neni 9**  
**Nënshkrimi i kontratës për angazhim**


Pas informimit të senatit me listën e bashkëpunëtorëve të jashtëm, rektori nënshkruan kontratat e të angazhuarve.

**Neni 10**  
**Të drejtat dhe obligimet**

1. Kandidatit të angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe kompensimin e përvojës së punës.
2. Angazhimi sipas kësaj rregulloreje nuk nënkupton themelim të marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
3. Në rast të konkurrimit për themelim të marrëdhënies së rregullt të punës aplikohen dispozitat e Statutit të UP-së për pozitën përkatëse.
4. Kandidatët e angazhuar bartin përgjegjësi ligjore për mënyrën e shfrytëzimit të aseteve të Universitetit të Prishtinës.

**Neni 11**  
**Dispozitat kalimtare**

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje hyjnë në fuqi nga dita e miratimit në senat.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja nr. 1/95, dt. 4.6.2021 e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës.



Kryesuesi Senatit të UP-së  
Prof. dr. Qerim Qerimi

Rektor